



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 22.4.2015, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Të ftuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës: Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral Nazmi Ibrahimaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- Zyra e Presidentes së Kosovës; Luanda Domi- DACF; Skënder Perteshi- QKSS; Ardiana Gashi- OSBE dhe Arbanë Pireva-praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje, u propozua ky

Rend i ditës:

Takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të ditës të propozuar:*

Takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletënant Rrahman Rama.

Kryetari- Sot e kemi të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, komandantin e ri të FSK-së, gjeneral Rrahman Ramën dhe gjeneral Nazmi Ibrahimajn. Më lejoni që në emër të Komisionit, t'ju urojmë detyrën e re, në krye të këtij misioni jo të lehtë, aq më tepër kur pritet që FSK-ja ta marrë një mision të ri, transformimin në Ushtri të Kosovës ose Forca të Armatosura. Ne, si Komision, jemi deklaruar të hapur, kurdo që Ministria e FSK-së e procedon pakon ligjore për transformimin e misionit tuaj, ne do të kryejmë obligimet tona. Takimi i sotëm është njoftues me komisionin, pasi keni marrë detyrën e re.

Kryetari, në vijim, prezantoi anëtarët e Komisionit dhe përkatësinë e tyre partiake dhe propozoi që fjalën t'ia japë gjeneralletënant Rrahman Ramës, dhe pas fjalës se tij, anëtarët e Komisionit mund të bëjnë pyetje dhe komente.

Gjeneralletënant Rrahman Rama- Ju faleminderit për ftesën për takimin me Komisionin parlamentar. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin që ju e keni pasur edhe me paraardhësin tim. Unë do të jem i gatshëm që në çdo kohë, në çdo moment ku ju e vlerësoni që ne duhet të jemi këtu, ne e kuptojmë rolin e Komisionit parlamentar dhe do të veprojmë në bazë të ligjeve dhe rregulloreve që i kemi në funksion. Detyra e komandantit të FSK-së, realisht nuk është detyrë e re për mua, pasi që unë kam qenë edhe si zëvendëskomandant, po ashtu edhe si komandant i Forcave Tokësore. Gjithashtu, jam i njoftuar me të gjitha sfidat që na presin, por edhe me sfidat që i kemi kaluar. Sa është nder dhe privilegj për mua, ka edhe shumë përgjegjësi dhe sfida. Tani më lejoni disa njoftime rreth aktiviteteve të FSK-së. Ne tani kemi filluar fushatën e deminimit në fusha të caktuara, ndërsa për një periudhë të caktuar, e kemi ndërprerë atë proces, për shkak të kushteve atmosferike. Po gjatë asaj periudhe, kemi bërë vetëdijesimin ndaj minave nëpër shkollat të ndryshme. Gjithashtu, kemi filluar praktikisht tash në terren në tri fusha. Shumë shpejt, do t'i kemi edhe dy fusha tjera. Kemi pasur dy kërkesa për kërkim-shpëtim, njëra në lumin Ibër, ku dyshohet që një i mitur ka rënë në lumin Ibër dhe jemi në javën e tretë duke bërë kërkim-shpëtimin në ujëra, por nuk kemi ende ndonjë rezultat. Gjatë kësaj periudhe, fatkeqësisht kemi gjetur një trup të pajetë të një qytetari që është i komunitetit serb, e kemi dorëzuar në organet kompetente, dhe si FSK, e kemi kryer detyrën tonë. Ne jemi në bashkëpunim me të gjithë aktorët, duket filluar me KFOR-in, EULEX-in dhe dy kryetarët e komunave, të pjesës veriore dhe asaj jugore. Ushtarët tanë e kryejnë punën në bazë të standardeve dhe kërkesave. Kemi bërë bartjen e mbetjeve mortore nga Spitali i Prishtinës në Çikatovë dhe në Rezallë.

Ne jemi në fazën e ndryshimit të misionit. Kemi pasur disa takime me ekipet përkrahëse në këtë proces dhe do të kemi vizitën DIRI (ekipet profesioniste nga SHBA-të) më 4 deri 8 maj, ndërsa mbas këtij takimi, presim që ta kemi një rezultat final që nga misioni, plani afatgjatë dhe struktura. Ne si Ministri dhe FSK, do t'i kemi edhe planet afatgjatë, por edhe strukturën.

Ju e dini që, ne edhe si Ministri, i kemi dërguar në Qeveri ligjet që duhet të ndryshohen dhe të tjerat janë çështje politike. Por, sa më shpejt që miratohen, krijohet mundësia për t'i realizuar planet dhe detyrat që dalin para nesh. Më 28-29 prill, kemi organizuar një konferencë e quajtur "Asistenca e Forcës" që i kemi ftuar të gjithë atashetë ushtarakë të akredituar në Kosovë dhe jemi koordinuar me KFOR-in, NATO-n, me ekipet këshilluese që janë në nivelin e Ministrisë dhe të Forcës së Sigurisë, ku përherë të parë, ne si FSK, jemi bartëse e kësaj konference dhe do të marrin pjesë të gjithë aktorët që do të jenë të përfshirë në këtë proces. Kjo do të jetë një kërkesë për harmonizimin e të gjitha planeve, projekteve, trajnimeve që do t'i kemi edhe do t'i

ndajmë me secilin shtet, se cilat janë interesat tona. Kemi pasur edhe një vizitë të rëndësishme nga disa ekspertë nga SHBA-të, pikërisht ka qenë për çështje të inteligjencës dhe të personelit, ka qenë një raport kthyes dhe tash ka ardhur. Po ashtu, janë bërë disa sqarime shpesh dhe kanë dalë disa ide të reja. Realisht, ky është edhe misioni, detyra edhe prioriteti im të zhvillimi i karrierës, sepse nuk kemi një zhvillim të mirëfilltë të karrierës. Kemi marrë disa inpute dhe disa ide. Jemi duke studiuar edhe ide të tjera, duke marrë edhe eksperiencë nga vendet e rajonit dhe të ushtrive shumë më të avancuara, por gjithmonë që janë natarë të NATO-s, gjithmonë duke i adaptuar në realitetin tonë. Jemi duke punuar edhe në doktrinë. Kemi bërë draftin e parë të doktrinės së përgjithshme, këtu e kemi një problem se nuk e kemi një doktrinë dhe një strategji nacionale që na e minimizon punën tonë, por shpresojmë që mbas rishikimit të sektorit të sigurisë që ka ndodhur në nivel qeveritar, do ta kemi edhe një strategji nacionale. Kemi pasur seminare edhe ekspertë nga SHBA-të, që kanë qenë dy herë këtu ku i kemi formuar grupet tona dhe e kemi hartuar draftin e parë të doktrinės së përgjithshme, gjithmonë me rekomandimet dhe marrjen e eksperiencave me vendet e ndryshme të rajonit, por edhe më gjerë. Doktrina është një dokument i gjallë dhe që mund të ketë ndryshime, varësisht nga detyrat që do të mund të dalin. Mbi bazën e doktrinės së përgjithshme lidhen edhe doktrinat veç e veç. Kemi filluar me tri doktrina: doktrina për operacion, doktrina për trajnime edhe doktrina për plane që ndërlidhen me doktrinën e përgjithshme dhe mbi bazën e planit që e kemi. Projekt tjetër i rëndësishëm është komunikimi strategjik. Fjala është për komunikim ushtarak dhe kemi punuar me Gardën Nacionale të Ajovas, kanë qenë disa herë këtu dhe kemi ardhur deri te një draft i përgjithshëm, duke e marrë parasysh rëndësinë që e ka komunikimi strategjik. Ne tash do t'i kemi edhe disa trajnime shpesh, e kemi ndarë buxhetin dhe kemi nënshkruar kontrata me kompani të caktuara që janë të specializuara për trajnime të komunikimit strategjik, por njëkohësisht, ne kemi filluar me projektin e komunikimit strategjik që shtatë vite dhe presim që në këtë vit edhe një projekt që është afërsisht 1 milion e gjysmë, që ta rrumbullakojmë atë komunikimin strategjik, por njëkohësisht, është i rëndësishëm së veçantë edhe trajnimi dhe profesionalizimi i ushtarëve dhe oficerëve që do të jenë pjesë të këtij projekti. Ne kemi pasur një kampanjë të rekrutimit dhe kemi përzgjedhur 336 pjesëtarë ose rekrutë të rinj nga shoqëria civile. E kemi ndarë në dy faza: faza e parë ka filluar në mars dhe pritet më 30 prill të përfundojë me 155 rekrutë të rinj, kurse në shtator do të fillojë edhe faza e dytë e rekrutëve të rinj. Në këtë vit, e kemi edhe diplomimin e 11 kadetëve nga Qendra Universitare e jona dhe kjo ceremoni do të jetë më 29 qershor, ku do ta ftojmë edhe komandantin e Gardës Nacionale të Ajovas.

Nuredin Ibishi- Desha t'ju uroj për detyrën e re dhe do të keni përkrahjen tonë, si Komision.

Fadil Demaku- Fillimisht, pasi ky është edhe takimi i parë, ne do të bëjmë maksimumin, në kuadër të normave ligjore, në bashkëpunimin sa më të mirë në mes të Komisionit, përveç mbikëqyrjes së punës së institucionit tuaj, do të japim edhe ndihmesën, si në aspektin politik, edhe në promovimin sa më të madh në misionin e ri.

Anton Quni- Nuk kam asnjë dyshim që ne do të vazhdojmë bashkëpunimin e mirë, ashtu siç e kemi pasur edhe me paraardhësit tuaj. Unë do ta ngre vetëm një çështje, para disa kohe është bërë publike nga kryeministri Mustafa, marrëveshja në mes autoriteteve të Qeverisë tonë, në mandatin e kaluar, dhe autoriteteve të NATO-s, në lidhje me angazhimin e forcave të armatosura në veri të Kosovës, është një marrëveshje politike. Më intereson, a është shtruar në tavolinë kjo temë nga autoritetet e NATO-s me ju apo me bashkëpunëtorët e juaj, si do të ekzekutohet në

rrafshin praktik, si do të jenë procedurat e vendimmarrjes, procedurat e angazhimit, proceduarat e kërkesave, po ashtu edhe bashkëpunimi?

Gjenerallejtënant Rrahman Rama- Nuk më takon mua që të komentoj deklaratat e të tjerëve dhe çdo vendim që merret nga autoritetet më të larta, ne do ta respektojmë. Nuk kemi asgjë zyrtare as nga pala jonë, as nga pala e NATO-s. Unë e përmenda edhe në fillim që ne jemi edhe në pjesën veriore, në bashkëpunim me të gjithë aktorët, duke filluar nga KFOR-i, dy kryetarët e komunave, EULEX-in dhe Policinë e Kosovës.

Zafir Berisha- Besojmë që e keni marrë punën me shumë seriozitet. Gjithsesi, edhe në emër të Komisionit dhe të subjektit që përfaqësoj, po edhe si qytetar i Republikës së Kosovës, do të keni mbështetjen sa herë që kërkohet nga legjislativi, veçanërisht nga komisioni ynë, pasi nga Komisioni në Kuvend, prezantohen shumë kërkesa që lidhen me objektivat dhe synimet e juaja.

Ganimete Musliu- Unë si deputete e këtij Komisioni do të jap kontributin tim për avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e me theks të veçantë, ndoshta do të jem më e zëshme kur janë në pyetje, sidomos anëtarët femra të kësaj Force, kështu që pres bashkëpunim edhe nga ana e juaj dhe shpresoj që në një të ardhme të afërt, shndërrimin në ushtri që do ta dëshironim të gjithë.

Qerim Bajrami- Ne si 6+, jemi pro ushtrisë së re të Kosovës. Për ne, nesër mund të vijë ligji në Kuvend. Ne e konsiderojmë FSK-në si ushtrinë tonë dhe nuk kemi asnjë kusht në këtë drejtim. Theksoi se vërejtjet nga grupi 6+ kanë të bëjnë me përfaqësimin e pjesëtarëve të këtij komuniteti, në të gjitha nivelet e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Tutje theksoi se ka probleme të mëdha në të gjitha nivelet e përfaqësimit, si në Policinë e Kosovës, po ashtu edhe në FSK. Sipas raportit, janë pak të përfaqësuar, ndërsa të dhënat janë jo të sakta, sepse ne si komunitet i kemi të dhënat tona dhe nuk përputhen me ato që janë në raportin vjetor të FSK-së.

Po ashtu, theksoi se qëllimi jonë është që të jemi në vende të caktuara dhe të përfaqësuar si komunitet që i përkasim grupit 6+. Si institucion serioz, nga ana e FSK-së kërkoj ndihmën e juaj dhe për këtë mospërputhje të të dhënave nga raporti juaj dhe të dhënave që kemi ne si komunitet. Për këtë, do të insistojmë si komunitet dhe të gjithë ata që janë boshnjakë të paraqiten boshnjakë dhe jo të zënë vendet.

Kryetari- Nuk na keni dhënë informatat, ku i keni marrë të dhënat. Ushtria është e qytetarëve të Kosovës, ndërsa për këtë do të përgjigjet Gjenerali, nëse ka individë që janë fshehur mbrapa ndonjë komuniteti, atëherë ekziston mundësia për t'u përmirësuar dhe duhet të përmirësohet, pasi që gatishmëria juaj ka qenë për t'i dhënë mbështetje FSK-së në shndërrimin në Forca të Armatosura.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama- Po e them përqindjen që e kemi, 8.9 % minoritete, pa dallime. Ne e kemi një zyrë për minoritete, në kuadër të Ministrisë dhe ata janë përgjegjës për të gjitha minoritetet. Përfaqësuesit tuaj kanë kontakte edhe ditore dhe lirisht ju mund t'i merrni ata numra, nëse ju intereson për komunitetin e caktuar. Ju e dini, që FSK-ja është multi-etnike. Cilido që i plotëson ato kritere që i kemi, për ne është i barabartë. Edhe te çështja e gradimit janë disa kritere. Janë disa rregullore dhe ligje që ne duhet t'i respektojmë dhe të gjithë ata që i

plotësojnë ato kritere, pa dallim se çfarë komuniteti është apo çfarë gjuhe flet, do të jetë pjesë e FSK-së.

Rexhep Selimi- Karakteri i këtij takimi është njoftues. Ju garantoj për mbështetjen tonë, siç ju thanë edhe deputetët tjerë. Më duhet të them që FSK-ja është institucioni më kredibil në Kosovë dhe me mbështetje më të madhe edhe nga grupimet politike. Kërkojmë edhe prej jush të punoni sa më shumë se sfidat i keni të mëdha, po ashtu edhe mbështetjen e keni të madhe.

Kryetari- E vlerësoj qëndrimin e z. Qerim, për shkak se është e domosdoshme vota e tyre dhe e drejta e tyre për të qenë pjesë, konsideroj që shqetësimet e tyre janë në kuadër të përfaqësimit parlamentar që e ka dhe shpresoj që edhe ju do t'i trajtoni këto shqetësime. Ajo që është më kryesorja, është se ne jemi të gatshëm, kurdo që Qeveria është donator i pakos ligjore, ne do e bëjmë punën tonë, në kuadër të përgjegjësi që i kemi, dhe e them me përgjegjësi të plotë, që jemi Komisioni më funksional në Kuvend, me gatishmëri të jashtëzakonshme për punë, njohës të mirë të rrethanave, për shkak edhe të kaluarës së tyre, FSK-ja është më e veçantë për ne pasi që ka kaluar një proces të gjatë dhe të vështirë. Mendoj që i ka ardhur koha që të jetë pjesë e barabartë me ushtritë e rajonit.

Kryetari, në fund të takimit, ftoi komandantin e FSK-së, anëtarët e Komisionit dhe stafin mbështetës për një drekë pune të përbashkët.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj